



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Tiranë, më datë 22.01.2020

Nr. 498 Prot.

VENDIM

Nr. 26, datë 22.01.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.01.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Koncepti i ndriçimit të Xhamisë së "Beqarëve", Xhamisë "Mbret", "Teqes së Helvetive", hartuar nga studio projektimi "TUMAS TURKISH ENGINEERING CONSULTING & CONTRACTING CO" dhe nga subjekt i licensuar ne restaurim znj. Adelina Baballëku me sugjerimet e mëposhtme:

Xhamia e Beqarëve

- Ndriçim në pjesën murale të monumentit dhe eliminim i ndriçimit në pjesën e poshtme;
- Ndriçimi në pjesën e brendshme të ballkonit dhe ndriçimi led në minare të jetë i zbehtë;

Xhamia Mbret

- Të mos ketë ndriçim tek portiku jashtë dhe të mbetet vetëm ndriçim i ambientit të brendshëm të tij,
- Ndriçim pikësor vetëm në harqet e dritareve dhe ndriçim sa më i lehtë në pjesën e çatisë,

Teqeja e Helvetive

- Ndriçimi me spote tek kollanat e hajateve të hiqet;
- Ndriçim i dritareve dhe vëllimit të brendshëm dhe jo ndriçim të jashtëm;
- Fasada e sipërme të ketë ndriçim sa më lehtë;

2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRËTAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

